



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE LEGJISLACIONIT

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

SPECIALIST I ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015 të Keshillit të Ministrave “Për pranimin, levizjen paralele, peridhen e proves dhe emerimin në kategorinë ekzekutive”, Bashkia Patos shpall Procedurat e levizjes paralele dhe e pranimin në shërbimin civil për pozicionin:

një vend pune në pozicionin Specialist i Zhvillimit të Bujqësisë në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Mjedisit, kategoria e pagës IV-4.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e levizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së levizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në Shërbimin Civil në kategorinë ekzekutive.

Për të dy Procedurat (levizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

12/06/2025

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

17/06/2025

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist i Zhvillimit të Bujqësisë:**

1. Të vlerësojë me objektivitet situatën aktuale të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Bashkinë Patos.
2. Të identifikojë dhe rekomandoj ndërhyrjet strategjike për zhvillimin rural në përgjithësi dhe të identifikoj zonat gjeografike në bashkinë Patos ku zhvillimi dhe ndërhyrjet do jenë më efektive dhe të vlerësuara.
3. Të hartojë koncepte projekti për ndërhyrje konkrete.
4. Të hartojë një plan përmirësimi për produktivitetin e fermave dhe të nxisë konkurrueshmërinë në bujqësi.
5. Të nxisë zbatimin e metodave të prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin dhe zbusin ndikimin mbi klimën, nëpërmjet zbatimit të praktikave më të mira të menaxhimit bujqësor dhe bujqësisë organike.
6. Të këshilloj fermerët, grupet e fermerëve dhe subjektet në drejtim të teknologjive të reja, drejtimit të fermës, aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj dhe marketingut në këtë fushë.
7. Të këshilloj dhe prezantoj tek fermerët skemat e subvencioneve të propozuara nga AZHBR, IPARD , USAID, UNDP etj, që kanë në fokus zhvillimin rural.
8. Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij.
9. Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen.
10. Ndjek korrespondencën që i është dhënë për trajtim, maksimumi brenda 10 ditëve, kur nga eprori nuk është caktuar një afat tjetër. Përgatit materialin dhe pasi e siglon ia paraqet Drejtorit të Drejtorisë.
11. Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditshme si dhe shqetësimet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon Drejtorit rrugëzgjidhjet përkatëse.
12. Realizon studime mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë e Patosit në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.
13. Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij ne lidhje me fushën e mbrojtjes së tokës.
14. Kryen studime për fusha të ndryshme dhe organizon sistemin e informacionit për sektorin që mbulon.
15. Organizon sistemin e administrimit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit.
16. Nxiti zbatimin e metodave të prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin dhe zbusin ndikimin mbi klimën, nëpërmjet zbatimit të praktikave më të mira të menaxhimit bujqësor dhe bujqësisë organike.
17. Organizon sistemin e administrimit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit.
18. Ndjek korrespondencën që i është dhënë për trajtim. Përgatit materialin dhe pasi e siglon ia paraqet përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit të drejtorisë.
19. Harton, në përputhje me fushën përkatëse të kompetencës, materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si dhe ndjek dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj diplomë “Bachelor”, Master Profesional ose Shkencor në Menaxhim Rural ose të ketë përfunduar Fakultetin e Shkencave të Natyrës. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të Statusit të nëpunësit civil.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim gjendjes shëndetsore;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion brenda datës 12.06.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **13.06.2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit

të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njëzore dhe Legjislacionit të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njëzore dhe Legjislacionit të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e legjislacionit si më poshtë:

- a. Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar
- b. Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- c. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- d. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”
- e. V.K.M nr. 410, datë 2.7.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”.
- f. Ligji nr. 131/2014 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” të ndryshuar.
- g. Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.
- h. Ligji nr. 10263, datë 8.4.2010, “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data dhe vendi i konkurimit do të njoftohet konkurrenteve.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Bashkisë Patos, duke filluar nga data 18/06/2025.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marre masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj diplomë “Bachelor”, Master Profesional ose Shkencor në Menaxhim Rural ose të ketë përfunduar Fakultetin e Shkencave të Natyrës. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Të ketë njohuri të njehsive të huaja.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësime pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucionin e Bashkisë Patos, brenda datës 17.06.2025.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18.06.2025**, Drejtoria e Burimeve Njërëzore dhe Legjislacionit të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njërëzore dhe Legjislacionit të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njërëzore dhe legjislacionit të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e legjislacionit si më poshtë:

- a. Ligji nr. 139/2015, “Per vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar
- b. Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- c. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- d. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”
- e. V.K.M nr. 410, datë 2.7.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”.
- f. Ligji nr. 131/2014 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” të ndryshuar.
- g. Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.
- h. Ligji nr. 10263, datë 8.4.2010, “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Patos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Patos duke filluar nga data 30/06/2025.

DREJTOR
Juela Shpata